



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:072806

Datë: 25.02.2025

Numri i dokumentit: 06901132

C.nr.229/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoreshen profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike të paditësit Xh.H nga Rahoveci, kundër të paditurës Xh.R nga Rahoveci të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Av. R.B nga Rahoveci, me objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, vlera e objektit të kontestit 1,000.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor më datën 18.02.2025, merr, ndërsa me datë 25.02.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Në bazë të pohimit

I. APROVOHET NË TËRËSI e bazuar kërkesëpadia e paditësit Xh.H nga Rahoveci.

II. VËRTETOHET se paditësi Xh.H nga Rahoveci, në bazë të parashkrimit fitues është pronar i sipërfaqes prej 58 m², pjesë e paluajtshmërisë së evidentuar si njësi kadastrale me nr.1560-1, ZK Rahovec, pronë private, vendi i quajtur “Kraishte”, me kulturë: “Tokë Ndërtimore”, e cila kufizohet: në anën veriore – lindore me parcelën kadastrale amë nr.1560-1, ZK Rahovec, në gjatësi prej 1.45m, në anën jug – lindore, me parcelën kadastrale nr.1560-2, ZK Rahovec, në gjatësi prej 24.91m, në anën jug – perëndimore me parcelën kadastrale nr.1554-0, ZK Rahovec, në gjatësi prej 3.41 m, dhe në anën veri - perëndimore me parcelën kadastrale nr.1560-1 ZK Rahovec, në gjatësi prej 24.09 m.

III. DETYROHET e paditura Xh.H nga Rahoveci, që ta pranojnë këtë të drejtë dhe që të lejojë regjistrimin e sipërfaqes prej 58 m², pjesë e paluajtshmërisë së evidentuar si pjesë e njësisë kadastrale me nr.1560-1, ZK Rahovec, në emër të paditësit në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e Rahovecit, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit.

IV. Shpenzimet procedurale i bartë pala paditëse.

A r s y e t i m

Fillimisht paditësi Xh.H nga Rahoveci, me datë 07.04.2022 në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurit Xh.R nga Rahoveci, për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të parashkrimit fitues (mbajtjes), në sipërfaqen e paluajtshmërisë prej 58 m², pjesë e paluajtshmërisë me nr.1560-1, ZK Rahovec.

Paditësi Xh.H përmasë parashtrës të datës 01.10.2024, ka bërë ndryshimin e padisë në kuptimin subjektiv dhe atë lidhur me legjitimitetin pasiv të palës, pasi që i padituri Xh.R ka vdekur me datë, fakti i cili është vërtetuar nga certifikata e vdekjes me numër serik, e lëshuar me datë 19.09.2024 nga Zyra e Gjendjes Civile në Rahovec. Ndërsa pas vdekjes së tij sipërfaqja prej 58 m², pjesë e paluajtshmërisë me nr.1560-1, ZK Rahovec sipas Kontratës mbi mbajtje të përjetshme është bartur në emër Xh.R nga Rahovecit, bashkëshortja e të ndjerit Xh.R.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 18.02.2025 në bazë të nenit 259 të LPK-së ka lejuar plotësimi dhe ndryshimi i legjitimitetit pasiv të palës, ashtu që e paditur në këtë çështje kontestimore në vend të Xh.R, do të jetë Xh.R.

Paditësi, si në padi ashtu edhe në shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar: Mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, si dhe deklarimeve të mëhershme. Meqenëse ka pranuar ekspertizën e ekspertit A.M, në tërësi e pranon, ngase e njëjta është bërë në mënyrë profesionale dhe e ka përshkruar gjendjen reale sikurse është në vend. Pjesa e parcelës kontestuese është në sipërfaqe prej 0.00,58 ha, e njëjta është në gjatësi prej 24.09 m, në anën jugore është 3.41 m dhe në anën veriore është në gjerësi prej 1.45 m dhe kështu bëj precizimin e saj me këto dimensione: Në anën veri-lindore kufizohet me parcelën kadastrale amë, në gjatësi prej 1.45 m, në anën jug-lindore me parcelën kadastrale nr. 1560-2, në gjatësi prej 24.91 m, në anën jug-perëndimore me parcelën kadastrale 1554-0, në gjatësi prej 3.41 m dhe në anën veri-perëndimore me parcelën 1560-1, në gjatësi prej 24.09 m. I njëjti ka theksuar se ndërsa me pohimin e palës paditëse janë plotësuar kushtet që gjykata të nxjerr aktgjykim në bazë të pohimit.

Shpenzimet procedurale ka deklaruar se do ti bartë pala paditëse.

Përfaqësuesi i autorizuar e të paditurës në përgjigjen në padi, seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar: Në tërësi mbetet pranë deklaratave të cekura në seancat paraprake. Nuk e konteston kërkesëpadinë e paditësit, ngase ish-i padituri, tani i ndjerë, edhe tani, e paditura Xh.R, pranojnë se pjesa kontestuese është pronë e paditësit, të cilën më parë e ka blerë prej ish-pronarit, por pasi që nuk është bërë ndarja dhe lidhja e kontratës formale, kjo pjesë ka mbetur si pjesë e tërë parcelës së të paditurit. Sa i përket ekspertizës së ekspertit, nuk ka vërejtje, ngase e njëjta është përpiluar në mënyrë profesionale dhe pasqyron gjendjen reale si është në vend. I njëjti ka theksuar pasi që e paditura në tërësi e pranon kërkesëpadinë e paditësit, një gjë e tillë edhe u vërtetua nga provat e proceduara, prandaj nuk e konteston kërkesëpadinë e paditësit dhe pranon që gjykata të bie aktgjykim në bazë të pohimit.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike ka caktuar shqyrtimin kryesor në të cilin kanë prezantuar palët ndërgjyqëse. Ka caktuar ekspertizën e gjeodezisë dhe se bashku me palët ndërgjyqëse ka dalë në vend. Eksperti i gjeodezisë është obliguar që të bëjë identifikimin e parcelës, sipërfaqen, kufizimet e parcelës dhe kush është në shfrytëzim të saj.

Gjithashtu, për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: Certifikatën e pronës, me nr. 08-942/03-0015769/22, e datës 31.03.2022, për parcelën kadastrale P-71510057-1560-2;

Certifikatën e pronës, me nr. 08-942/03-0015769/22, e datës 31.03.2022, për parcelën kadastrale P-71510057-1560-1; Skicë e matjes, e datës 18.11.2021 dhe 1 foto A4, me ngjyrë; Certifikatën e vdekjes, me nr.ser., për të ndjerin Xh.R, e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Rahovec, me datë 19.09.2024; Certifikatën e pronës, me nr. 1219-2024, e datës 20.09.2024, e Xh.R t; dhe Ekspertizë ne gjeodezisë, e ekspertit A.M, e dorëzuar në këtë gjykatë me datë 13.01.2025, së bashku me skicën e terrenit, aktvendimin 1219-2024, të Zyrës Kadastrale Komunale në Rahovec dhe certifikatën e pronës me nr. 1219-2024.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Gjykata me administrimin e certifikatës së paluajtshmërisë me numër të lëndës 1219-2024, e datës 20.09.2024 dhe ekspertizës së gjeodezisë të datës 13.01.2025 (të cilave ua dha besimin e plotë) ka vërtetuar faktin se parcela nr.1506-1, ZK Rahovec, në sipërfaqen të përgjithshme prej 2614 m², evidentohet në emër të të paditurës Xh.R, me pjese ideale 1/1.

Gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar duke qenë se e paditura e ka pohuar kërkesëpadinë, që nga fillimi i procedurës e deri në përfundim të saj, ku e paditura Xh.R pohimin e kërkesëpadiës e ka bërë përmes përfaqësuesit të autorizuar të tij .

Gjykata nga shqyrtimi i gjithmbarshëm i çështjes, edhe përkundër pohimit të kërkesëpadiës nga e paditura, ka shtyrë marrjen e aktgjykimit në bazë të pohimit, kurse sipas propozimit të paditësit me qëllim të verifikimit dhe marrjes së njoftimeve të duhura në kuptim të nenit 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka caktuar seancën e vend shikimit dhe nxjerrjen e provës përmes ekspertizës së gjeodezisë.

Gjykata pas analizimit të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, thënieve në padi dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga e paditura, ka gjetur se janë në harmoni me njëra tjetrën dhe me pohimin e palës së paditur, nga të cilat vërtetohen faktet relevante se palët mund të disponojnë me kërkesat e tyre, pasi i padituri është evidentuara si pronar i paluajtshmërisë, që vërtetohet përmes certifikatës së paluajtshmërisë, me numër të lëndës 550-2018, e datës 12.09.2018.

Gjykata pas pohimit të kërkesëpadiës nga ana e të paditurës, konstatoi se kërkesa është e disponueshme për palët, prandaj në kuptim të nenit 148.1 të Ligjit të procedurës Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *“në qoftë se i padituri deri në përfundim të shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesën (aktgjykimi në bazë të pohimit)”*, vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në kuptim të nenit 455 LPK-së, gjykata ka vendosur sikurse në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Mbi bazën e parashtrimeve të mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 143 dhe 148.1 të LPK-së.

GJYKATA E THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.229/2021 më datë 25.02.2025

Bashkëpunëtore profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët mund të ushtrojnë ankese në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate. Në kuptim të nenit 181 par.2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.